

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - Mall

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURES: “Blerje mobilje per OSHEE Group sh.a dhe Bijat per dy vite”

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV): - -
39100000-3 - Mobilje

VLERA E FONDIT LIMIT: Marrëveshje kuadër me fond limit total 103,785,400 (njëqind e tre milion milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë pa TVSH dhe 1,052,483.5 (një milion e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë pesë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 27.12.2024, është 98.61 lekë).

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Ne baze të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” datë 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE Group sh.a” ka vendosur që kjo procedure të mos jete në lotë sipas arsyetimit të mëposhtem:

Kjo kontratë nuk është ndarë në lotë pasi administrimi i saj do të bëhet nga OSHEE Group sh.a, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga OSHEE Group sh.a, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim.

Gjithashtu objekti i kontratës lidhet me furnizim me mallra /mobiljeve që tregohen nga operator ekonomik prodhues/perpunues ose tregëtues të cilët ofrojnë totalisht ose janë në linjën e furnizimit të kategorive të mallrave të kërkuara. Përsa më lart ndarja në lotë nuk do të kishte kuptim, vështirësonte furnizimin dhe procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe shpenzime operative shtesë dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi dhe vonesa për menaxhimin e kontratës duke dubluar një sërë procesesh zinxhir. Autoriteti Kontraktor OSHEE Group sh.a ka në vartësi strukturën dhe mënyrën për të ofruar të gjitha shërbimet lidhur me proceset e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave, ndaj në këtë kuadër ka krijuar strukturën dhe trajnuar personelin për mbulimin e ketyre shërbimeve.

Bazuar ne nenin 52 te Ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 59 e ne vijim te V.K.M. nr.285, date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe udhezimeve dhe manualeve ne zbatim te akteve te sipercituara, eshte zgjedhur Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik - ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 mujor, pasi blerjet e mallrave dhe si pasoje furnizimet e njesive shrytezuese te varesise se AK, do te kryhen ne menyre periodike dhe nevoja per keto mallra eshte me karakter periodik, ne vazhdimesi por dhe te qendrueshem ne afatin kohor te percaktuar.

Kjo procedure e perzgjedhur garanton dhe siguron efektivitet ne lidhje me shpejtesine e realizimit te furnizimit ne kohe te caktuar, pasi ato do te kryhen ne menyre periodike dhe ne varesi te mundesive dhe veprimtarise se Autoritetit Kontraktor.

Ne rastin e kesaj procedure Marreveshja Kuader me shume operatore ekonomike do te sillte vonesa, konfuzion dhe larmi cilesie, disenjosh dhe ngjyrash per objekte te vecanta ne listen e artikujve te kerkuar ndonese keta artikuj ne shumicen e rasteve jane per perdorim Brenda nje ambjenti. Ne kete menyre aplikimi me shume operatore ne rastin konkret do te ishte joefektive.

Marreveshja kuader me nje operator ekonomik garanton realizimin e sherbimit ne kohe, ne afat dhe ne llojin dhe cilesine e kerkuar te objektit te prokurimit, pasi kemi perseritje te shpeshta te kryerjes se furnizimeve per nevojat e institucionit dhe atyre te vartesise.

Nje argument tjetër i perzgjedhjes se Marreveshjes Kuader, ka te beje edhe me natyren se mallrave te furnizuara, pasi gjykohet me efikase qe ky furnizim te ofrohet nga Operatori Ekonomik, sa here ka nevojë autoriteti kontraktor.

Duke qene se te gjitha kushtet jane te percaktuara, autoriteti kontraktor, vendosi qe lloji i marreveshjes kuader, bazuar ne nenin 59 e ne vijim te V.K.M. nr.285, date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, do te jete me 1 (nje) operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara

Ne keto kushte nuk do te kete rihapje te konkursit. Kontratat do te lidhen sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor te percaktuara ne DST, me operatorin ekonomik te suksesshem. Komunikimi ndermjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar, ose elektronike (e-mail, fax, etj.).

Sasite e parashikuara nga AK jane vetem sasi orientuese dhe NUK e kushtezojne Autoritetin Kontraktor per t’i blere ato domosdoshmerisht dhe totalisht.

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te parashikuara. (por ne çdo rast brenda vleres se perlllogaritur te marreveshjes kuader). Kontraktuesi nuk do te kete te drejte kompensimi dhe NUK do t’i lejohet te beje ndryshime te çmimeve te njesise, per shembull ne rast se autoriteti kontraktor vendos te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te specifikuar dhe/ose ne rast se autoriteti kontraktor vendos te mos bleje asnje nga keto sasi per disa artikuj.

Çmimet per njesi jane percaktuar ne Formularin e Çmimit te Ofertes. Çmimet e njesive duhet te jene fikse dhe nuk duhet t'i nenshtrohen ndryshimeve per porosite e vendosura ne kete marreveshje kuader.

Ne hartimin e Kriterëve të përgjithshme të Kualifikimit, është Formulari Standard i cili respekton kërkesat dhe kufizimet e nenit 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të V.K.M. nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. perkatesisht

KRITERET E PERGJITHSHME TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Lidhur me kriterin

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimpruese, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-se;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyresë, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrese ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prërë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-se;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prërë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dhe nuk ka pagesa paslyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-se;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorin Ekonomik, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka ne cilesine e anetarit te organit te administrimit, drejtues ose mbikeqyres i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona te cilet jane/kane qene ne kete cilesi ne nje operator ekonomik te perjashtuar nga e drejta per te perfituar fonde publike, me vendim te Agjencise se Prokurimit Publik, gjate kohes qe ky vendim eshte ne fuqi.

Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip.

Keto kriteret duhet te permbushen me paraqitjen e Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te operatorit ekonomik ne ditën e hapjes se Ofertes, sipas Shtojces 8.

Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendur.

Ne rast se operatori ekonomik ofertues do te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, Vetedeklarimi i lartpermendur duhet te paraqitet edhe nga subjekti mbeshtetes.

Kriteret e Pergjithshme te Pranimit nuk duhet te ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Ne çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme per vertetesine e informacionit te deklaruar nga Operatori Ekonomik, per sa me siper.

Nese oferta paraqitet nga nje bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet :

Marreveshje bashkepunimi ndermjet Operatoreve Ekonomike, ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesemarrjes ne bashkm, dhe elementet qe merr persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit.

Nese, nje operator ekonomik deshiron te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, ai i verteton autoritetit ose entit kontraktor se do te kete ne dispozicion burimet e nevojshme, duke dorezuar nje angazhim me shkrim te ketyre subjekteve per kete qellim.

Argumentimi: Kriteret e pergjithshme te Kualifikimit jane sipas Formularit Standard i cili respekton kerketat dhe kufizimet e nenit Neni 77 “Kerketat per kualifikim” te Ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Seksionit II te ‘Kerkesa te vecanta sipas tipeve te kontratave’ te V.K.M. nr.285, date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar dhe per cdo kerkese te vecante AK I permbahet aresyetimit:

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

Lidhur me kriterin

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

a. *Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8*

b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme bazohen ne nenet 76, 82 dhe 83 te LPP, nenit 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Lidhur me kriterin

Ofertuesi duhet te paraqese:

2.1. Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale (nese eshte e aplikueshme):

Referuar pikes 1 te shtojces 8, ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit. Keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 8.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, te LPP, nenit 40, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojces 8 te DST-se.

Lidhur me kriterin

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/5,6, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marre ne konsiderate llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontrates se Marreveshjes Kuader per kete objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te deshmoje se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara.

Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim eshte kerkuar vertetim i xhiros per tre vitet e fundit ne nje vlere jo me e vogel se 100% e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet ne nje nga vitet e periudhes se percaktuar.

Kerkesa per 100 % eshte konsideruar e drejte pasi AK pavaresisht koheshtrirjes prej 24 muaj te Marreveshjes Kuader, e ka te pamundeur te percaktoje permasat e kontratave specifike apo shumes se kontratave specifike qe do te realizohen brenda nje viti..

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar Ligjin nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e percaktuar ne piken 1 te ketij neni dorezojne deklaraten vjetore te te ardhurave prane administrates tatimore qendrore, jo me vone se data 30 prill e vitit qe pason periudhen tatimore, per te cilen behet deklarimi”*.

Lidhur me kriterin

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shemin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga OE vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te nenit 41, germa “c” te Ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridike qe detyrohen per auditimin ligjor te pasqyrave financiare detyrohen te kryejne auditimin ligjor te pasqyrave financiare vjetore, perpara publikimit te tyre, nga eksperte kontabel ose shoqeri audituese: "c) shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, te cilat zbatojne per raportimin financiar standardet kombetare te kontabilitetit, kur, ne mbyllje te periudhes kontabel, per dy vite radhazi, tejkalojne dy prej tre treguesve te meposhtem: i) totali i aktiveve te bilancit, ne mbyllje te periudhes kontabel perkatese, arrin ose e kalon shumen prej 50 milione lekesh; ii) shuma e te ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) ne ate periudhe kontabel arrin ose e kalon shumen prej 100 milione lekesh; iii) ka, mesatarisht, 30 te punesuar gjate periudhes kontabel”

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP ku citohet “.... Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore qe te tregojne raportet ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.....”, si dhe nenit 43, pika 4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, Ligji nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar dhe ne zbatim te Nenit 41, pika c, te Ligjit Nr.10091, date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”, i ndryshuar.

Lidhur me kriterin

2.2.3 Operatoret ekonomike duhet te paraqesin “Vertetim per shlyerjen e taksave vendore” te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2024, sipas kesteve te parashikuara ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, çdo anetar i grupit duhet te dorezoje vertetimin leshuar nga Autoriteti perkates ne te cilen eshte regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Te gjithë subjektet qe ushtrojne veprimtari biznesi kane detyrimin ligjor te regjistrimit prane Qendres Kombetare te Biznesit per te bere te identifikueshem vendodhjen e aktivitetit te tyre dhe per tju nenshtuar pageses se taksave vendore te parashikuara shprehimisht ne kete ligj

Lidhur me kriterin

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per realizimin me sukses te nje ose disa kontratave te meparshme te ngjashme, te kryera gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 40% te vleres se perlllogaritur fondit limit qe prokurohet.

Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmite e meposhtme:

per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe fatura tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara,

per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te Nr. 162/2020 “Per prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten per natyren, funksionin, cilesine etj. karakteristika specifike te produkteve te kerkuara e cila ne rastin e prodhuesve/perpunuesve lidhet me teknologjine, pervojen, aftesine, disiplinen teknike te realizuar edhe me pare por edhe per tregetuesit e artikujve tregon angazhimin e tyre ne te kaluaren per gjetjen e tregjeve, garantimin e furnizimit, menaxhimin e detyrave qe kushtezojne nje levizje dhe furnizim te sukseshem ne realizimin e kontrates, prandaj eshte kerkuar qe furnizimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 40 % se vleres se perlogaritur te kontrates se Marreveshjes Kuader, qe eshte ne kete rast brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave te kerkuar ne kete objekt procedure prokurimi, e cila nga AK mendohet se eshte e konsiderueshme, gjykohet se ne baze te kompetences qe legjislacioni i jep AK, vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete realizuar me kontrata te ngjashme te jete sa limiti maksimal i lejuar dhe ne kete menyre, AK krijon sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Lidhur me kriterin

2.3.2 Operatori ekonomik pjesemarres duhet te jete i certifikuar si kompani sipas standardeve nderkombetare dhe te paraqese:

ISO 9001:2015 ose ekuivalente, "Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise" (e vlefshme);

ISO 14001:2015 ose ekuivalente perfshire Leje Mjedisore, „Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme);

ISO/ 45001:2018/ ose i perditesuar 2023 ose ekuivalente, "Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune" (e vlefshme);

UNI EN ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente , "Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike" (e vlefshme);

Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas fushes se objektit qe do te prokurohet.

Çertifikatat te jene leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas akt-marreveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40 dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri vertetues (lidhur me disponimin e ISO 9001) kërkohet që operatori ekonomik të deshmojë që kompania ka dhe zbaton mënyrën e duhur dhe garantuese të cilësive të menaxhimit të përgjithshëm të kompanisë, sistemin e duhur organizativ, mjetet e nevojshme, specialistet dhe dokumentacionin e aplikueshëm parandalues dhe konfirmues të cilësive në çdo hallkë të procesit të prodhimit deri në produktin e gatshëm, shpërndarjen, montimin dhe vendosjen në vend të produkteve apo menaxhimin me fokus respektimin dhe kontrollin e cilësive në aktivitetin tregëtar të blerjes, shitjes, shpërndarjes dhe vendosjes në vend të produkteve të kërkuara.

Me anë të kriterit vertetues (lidhur me disponimin e ISO 14001) kërkohet që operatori ekonomik të deshmojë se në kompani zbatohen rregulla menaxhuese dhe organizative për përdorimin e lendeve të para që rrjedhin nga burime që respektojnë dhe mbrojnë mjedisin, por dhe organizimi i kompanisë në të gjithë hallkat e prodhimit tregëtar për të mirëadministruar proceset dhe respektuar normat mjedisore.

Me anë të kriterit vertetues (lidhur me disponimin e ISO 45001) kërkohet që operatori ekonomik të deshmojë se në kompani zbatohen menaxhuese dhe organizative që respektojnë dhe mbrojnë shëndetin dhe jetën e punonjësve.

Me anë të kriterit vlerësues (lidhur me disponimin e ISO 3834-2:2006) kërkohet që operatori ekonomik të deshmojë se kompania ka aftësitë teknike dhe teknologjike për realizimin e produkteve cilësore në saldimet metalike. Ky kriter se bashku me certifikimet dhe kualifikimet individuale të profesionistëve të saldimit, garanton autoritetin kontraktor se produkti final do të jetë në përputhje me specifikimet dhe kërkesat cilësore.

Çertifikimi si më sipër ose ekuivalent të jenë leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Lidhur me kriterin

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur është i profilit prodhues duhet të ketë të punësuar të paktën 30 (tridhjetë) punonjës, kur është i profilit tregëtar (kur është tregëtar i mbi 50 % të numënklatures së artikujve të kërkuar) jo më pak se 22 punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Kriteri 2.4.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40 pika 5 “c” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet;

5. “Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kerkon:

fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose ..”

AK gjykon se:

Operatoret ekonomike prodhues - perpunues/perpunues te cilet perfshihen ne konkurim kane domosdoshmerisht nevojten per disponimin e nje numri punonjesisht (staf menaxherial + inxhiniero – Teknik + punonjes prodhimi dhe ndihmes) qe AK ka percaktuar numrin 30 punonjes minimalisht.

Kjo pasi nga pervoja e AK, renia ne kontakt me leteraturen e industries se prodhimit te mobiljeve, Numrin e makinerive dhe proceseve te punes qe pernorin keta kompani, raportin normal qe zene funksionet e punonjesve prodhues – perpunues - perpunues/joprodhues ndaj totalit te punonjesve ne nje kompani, analizimi i te dhenave te sipercituara bene qe AK te percaktoj si numer minimal te domosdoshem per kompanite prodhuese/perpunuese prej 30 punonjesisht.

Vetem ne proces prodhimi kompanite realizojne prodhimin e artikujve te mobilerise nepermjet

makinerive te prerjes se pllakave te MDF apo melamines

makinerive te veshjes anesore me PVC (bordimit)

makinerive te hapjes se vrimave te nevojshme per montim

makinerive te perpunimit sipërfaqesor

makinerive te veshjes sipërfaqesore

makinerive te perdorimit te ngjitesave

makinerive te presimit

makinerive te formimit

makinerive apo linjave te lyerjes

paisjeve te saldimit metalik

linjave te lyerjes elektrostatische

makinave te prerjes, qepjes dhe formimit te materialeve te buta

tapicimit

montimit (formimit) ne fabrike te cdo produkti te prodhues

pastrimit

ambalazhimit

magazinimit

etj procese ndihmese para, gjate dhe pas marrjes se produktit te gatshem

Shperndarjes

montimit te ampjentet e porositetit

Ne cdo process pune sikurse u pershkrua me siper per operatoret prodhues per efekt rendimenti, lodhje fizike, sigurie ne pune etj mund te konsiderohen minimalisht 1-2 punonjes e ne raste te vecanta menaxhimi i me shume se nje procesi nga I njeiti punonjes..

Percaktimi i munrit te punonjesve minimal te domosdoshem prej 22 punonjesish ne operatoret ekonomike qe jane te profilit tregetues konsiderohet numer minimal i nevojshem dhe i domosdoshen sepse, nga pervoja e AK si dhe studimi i proceseve te punes ne zinxhirin e evidentimit te subjekteve te bashkepunimit ne biznes te ketyre OE, lidhjes se kontratave, nevojës per transport, magazinimit, seleksionimit, ndarjes sipas porositet, ngarkim/shkarkimit, montimit pjesor ne magazine e OE, shperndarja dhe montimi prane porositetit, raportit ndermjet punonjesve te administrates dhe jo te administrates eshte konceptuar dhe vendosur qe ky numer te jete minimalisht 22 punonjes.

Nderkohe AK mbi bazen e listes totale te artikujve ka menduar qe ne kete rast prodhues i mirefillte te konsiderohet operatori qe ofron mbi 50 % te artikujve qe vijne nga procesi i prodhimit dhe me pak se 50 % nga aktiviteti tregetar, e po keshtu tregetues i mirefillte me numer minimal punonjesish 22 eshte menduar qe te konsiderohet subjekti qe ofron mbi 50 % te nomenklatures se artikujve te kerkuar si artikuj qe vijne nga aktiviteti tregetar i tij.

Lidhur me kriterin

2.3.4 Operatori ekonomik sipas natyres se tij prodhues apo tregetues (operator prodhues konsiderohen ato operatore qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operator tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve me kode respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve si ne ne tablele:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve	Kodi orientues korespondues i profesionit ose kode te peraferta profesionale sipas VKM nr. 514, date 20.9.2017
1	Inxhinier druri (prodhues)	1	2141.01
2	Arkitekt (prodhues dhe operatorët tregetues)	1	2161.04
